



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHERBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2025
ME ZGJEDHJE – SESIONI I
SKEMA E VLERËSIMIT

LËNDA: GJEOGRAFI

Pyetjet me alternativa

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	C	C	D	B	D	A	A	D	D	C
Pyetja	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
Përgjigja e saktë	A	D	D	C	B	B	C	D	C	A

Pyetjet me zhvillim

Shënim: Për pyetjet me zhvillim, nxënësi fiton pikët, edhe nëse jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta.

Pyetja 21 3 pikë
Përgjigje

- a) Projektion azimutal polar
b) Paralelet paraqiten si rathë bashkëqendrorë.
c) Projektioni azimutal polar përdoret më shumë kur duam të paraqesim zonat polare, ndërsa projektioni cilindrik për paraqitjen e dukurive gjeografike me karakter zonal ose për të paraqitur zonat afër ekuatorit.

- 3 pikë** Nëse jep llojin e projeksonit, mënyrën si paraqiten paralelet dhe një ndryshim midis dy llojeve të projekSIONEVE.
2 pikë Nëse jep llojin e projeksonit dhe mënyrën si paraqiten paralelet OSE llojin e projeksonit dhe një ndryshim midis dy llojeve të projekSIONEVE.
1 pikë Nëse jep llojin e projeksonit OSE mënyrën si paraqiten paralelet OSE një ndryshim midis dy llojeve të projekSIONEVE
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 3 pikë
Përgjigje

Në gjerësitë ekuatoriale: Erërat e Pasateve/Alizeve.
Në gjerësitë mesatare: Erërat Perëndimore.
Në gjerësitë polare: Erërat Lindore.

- 3 pikë** Nëse emërton tri llojet e erërave.
2 pikë Nëse emërton dy nga llojet e erërave.
1 pikë Nëse emërton një nga llojet e erërave.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23**3 pikë****Model përgjigjeje**

- Në det të hapur kanë lartësi të ulët deri në 0.5 m.
- Lartësinë më të madhe e arrijnë kur përplasen në breg (shkon deri në 30m lartësi).
- Kanë shpejtësi me qindra km/orë.
- Kanë forcë të madhe shkatërruese.
- Shkaktohen nga tërmetet nënujore.
- Etj.

- 3 pikë** Nëse jep tri nga karakteristikat.
2 pikë Nëse jep dy nga karakteristikat.
1 pikë Nëse jep një nga karakteristikat.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.
-

Pyetja 24**3 pikë****Përgjigje**

Procesi: diagjeneza

Llojet: Shkëmbinj sedimentarë copëzorë, kimikë, organogjenë

- 3 pikë** Nëse përcakton procesin që çon në formimin e shkëmbinjve sedimentarë dhe dy nga llojet e shkëmbinjve.
2 pikë Nëse përcakton procesin që çon në formimin e shkëmbinjve sedimentarë dhe një nga llojet e shkëmbinjve.
1 pikë Nëse përcakton procesin që çon në formimin e shkëmbinjve sedimentarë OSE një nga llojet e shkëmbinjve.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare
-

Pyetja 25**Përgjigje**

a)

1 pikë

Korazion

- 1 pikë** Nëse emërton saktë llojin e veprimtarisë shkatërruese.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

b)

2 pikë

Kërpudhat shkëmbore

Kolonat shkëmbore ose shtyllat shkëmbore

- 2 pikë** Nëse përcakton dy format e relievit.
1 pikë Nëse përcakton një nga format e relievit.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.
-

Pyetja 26**3 pikë****Model përgjigjeje***Vija bregdetare e rajonit:*

Në raport me rajonet e tjera ka vijë bregdetare pak të thyer. Ka pak ishuj, gadishuj dhe gjire. Ishulli më i madh është ai i Madagaskarit.

Hidrografia e rajonit:

Është mjaft e pasur me lumenj dhe liqene të mëdhenj ku mund të përmendim lumenjtë Kongo, Zambia, Limpopo, Orazh si dhe liqenet me origjinë tektonike si Viktoria dhe Tanganika. Ato që furnizohen nga shirat ekuatoriale janë të pasur për burime hidrike. Përdoren për ujitje dhe komunikacion.

Mjedisi jetësor i zonës ekuatoriale të rajonit:

Ky mjedis përfshin gjirin e Guinesë dhe pellgun e Kongos me klimë tipike ekuatoriale. Dallohet për pyllin e lartë e të dendur ekuatorial. Ka bimësi dhe botë shtazore shumë të pasur.

3 pikë

Nëse evidenton tri tiparet dalluese.

2 pikë

Nëse evidenton dy nga tiparet dalluese.

1 pikë

Nëse evidenton një nga tiparet dalluese.

0 pikëNëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare**Pyetja 27****3 pikë****Model përgjigjeje**

a)

Andet ose Kordilieret e Andeve

b)

Në pjesën lindore të Amerikës Jugore hidrografia është shumë e pasur me mbizotërim të sistemeve lumore të Amazonës, Orinokos dhe Parana-Paraguaj.

Pjesa perëndimore ndryshe nga ajo lindore për shkak të relievit malor ka lumenj të shkurtër dhe me luhatje të rrjedhjeve.

Dallohet për liqene me origjinë tektonike si Titikaka, Popos në pjesën e Andeve.

Amazona përfaqëson lumin me pellgun më të madh ujëmbledhës në botë.

Liqeni Titikaka me origjinë tektonike dhe me shtirje shumë të lartë mbi nivelin e detit. lumenjtë Parana e Paraguaj derdhen në gjirin e madh të La Platës etj.

3 pikë

Nëse evidenton sistemin më të lartë malor dhe dy nga veçoritë e hidrografisë së rajonit.

2 pikë

Nëse evidenton sistemin më të lartë malor dhe një nga veçoritë e hidrografisë së rajonit OSE dy nga veçoritë e hidrografisë së rajonit

1 pikë

Nëse evidenton sistemin më të lartë malor OSE një nga veçoritë e hidrografisë së rajonit.

0 pikëNëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.**Pyetja 28****3 pikë****Model përgjigjeje**

- Verë e thatë dhe e nxehtë dhe dimër i ashpër, i ftohtë.
- Amplituda të mëdha vjetore të temperaturave.
- Reshje më të pakta e në formën e dëborës.
- Ndikim i dukshëm i masave ajrore të ftohta nga pjesa lindore e veriore e saj.
- Etj.

Pjesa veriore:

Shfaqen tiparet klimatike subpolare.

Pjesa jugore:

Shfaqen tipare klimatike mesdhetare

3 pikë	Nëse evidenton tri tiparet dalluese.
2 pikë	Nëse evidenton dy nga tiparet dalluese.
1 pikë	Nëse evidenton një nga tiparet dalluese.
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 29 **3 pikë**

Model përgjigjeje

- a)
- Popullsia metise e krijuar nga përzierja e popullsisë vendase me atë të ardhur evropiane.
 - Popullsia me prejardhje evropiane.
 - Popullsia afrikane, pasardhës të popullsisë afrikane të ardhur në këtë rajon për të punuar në plantacione.
 - Popullsia aziatike, të ardhur nga Indokina, Malajzia, Kina etj., për të punuar plantacione.
 - Popullsia mulate e krijuar nga përzierja e popullsisë afrikane me atë të ardhur evropiane.
- b) Maja OSE actekët.
- | | |
|---------------|--|
| 3 pikë | Nëse përcakton dy nga grupimet e popullsisë dhe një nga qytetërimet. |
| 2 pikë | Nëse përcakton dy nga grupimet e popullsisë OSE një nga grupimet e popullsisë dhe një nga qytetërimet. |
| 1 pikë | Nëse përcakton një nga grupimet e popullsisë OSE një nga qytetërimet. |
| 0 pikë | Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare. |

Pyetja 30 **3 pikë**

Model përgjigjeje

- Regjimi shumë i çrregullt i rrjedhjes.
- Pjerrësia e madhe e pellgut ujëmbledhës të ndërtuar në shkëmbinj të butë.
- Regjim mesdhetar,
- Jane të rrëmbyeshëm
- Dëmtimi i bimësisë natyrore.
- Etj.

3 pikë	Nëse jep tri nga faktorët.
2 pikë	Nëse jep dy nga faktorët.
1 pikë	Nëse jep një nga faktorët.
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare

Pyetja 31 **3 pikë**

Model përgjigjeje

- Rritja e të ardhurave duke siguruar mundësi më të mira pune dhe siguruar të ardhura më të larta për veten dhe familjet e tyre.
- Mbështetje financiare për familjet në Shqipëri nëpërmjet remitancave.
- Përmirësimi i nivelit arsimor dhe profesional. Shumë shqiptarë patën mundësi të ndjekin shkollime dhe trajnime profesionale më cilësore në vendet ku emigruan, duke përfituar nga një sistem arsimor më i zhvilluar.
- Eksperienca dhe njohuritë e reja. Emigrantët fituan përvoja të reja në fushën e punës, biznesit dhe jetës sociale, të cilat mund t'i përdorin për të kontribuar në zhvillimin e Shqipërisë në të ardhmen.
- Mundësi investimi në Shqipëri. Disa emigrantë kanë investuar kursimet e tyre në ndërtimin e shtëpive, hapjen e bizneseve apo zhvillimin e projekteve të ndryshme në Shqipëri.
- Lidhje më të forta me botën. Emigrimi ka ndihmuar në krijimin e lidhjeve më të ngushta mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera, duke ndihmuar në integrimin e shqiptarëve në komunitetin ndërkombëtar dhe në përmirësimin e imazhit të vendit.
- Etj.

- 3 pikë** Nëse jep tri nga pasojat pozitive.
2 pikë Nëse jep dy nga pasojat pozitive.
1 pikë Nëse jep një nga pasojat pozitive.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 32 **3 pikë**

Model përgjigjeje

- Dalja e gjerë në detin Adriatik
- Relievi fushor - kodrinor
- Mbrojtja nga lindja prej erërave të ftohta.
- Etj.

- 3 pikë** Nëse rendit tri nga arsyet.
2 pikë Nëse rendit dy nga arsyet.
1 pikë Nëse rendit një nga arsyet.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 33 **4 pikë**

Model përgjigjeje

Ndikimet pozitive	Ndikimet negative
Mundësi punësimi	Prishje të ekuilibrave mjedisore, ndotje
Rritje e të ardhurave	Problem me menaxhimin e mbetjeve
Përmirësim i infrastrukturës	Ndërtime pa kriter
Përmirësim i jetës sociale	Diskriminim
Etj.	Etj.

- 4 pikë** Nëse përcakton dy nga ndikimet pozitive dhe dy nga ndikimet negative.
3 pikë Nëse përcakton dy nga ndikimet pozitive dhe një nga ndikimet negative ose një nga ndikimet pozitive dhe dy nga ndikimet negative.
2 pikë Nëse përcakton një nga ndikimet pozitive dhe një nga ndikimet negative.
1 pikë Nëse përcakton një nga ndikimet pozitive OSE një nga ndikimet negative.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.